



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
Mbledhja nr. 38/18
Prishtinë, më 05.12.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Jelena Bontic, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Enver Hoti. Blerim Kuçi dhe Fikrim Damka.

Munguan: Dardan Molliqaj dhe Safete Hadergjonaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza - Ministri i Financave dhe Lulzim Rafuna - Këshilltar i Ministrit.

Pjesëmarrësit tjerë: Nora Kokaj nga Zyra e BE-së, Besart Blakaj nga Shoqata e Sigurimeve, Agnesa Haxhiu nga KDI, Blendi Sopi nga KDI, Vatra Qehaja nga LVV, Shefki Gerbovci nga Shoqata e Sigurimeve, Kadri Jogiste nga GIZ, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Artane Rizvanolli (eksperte e jashtme e angazhuar nga GIZ-i).

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku – Kryetar (tutje kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-136 për ratifikimin e Marrëveshjes për Kredi, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria Ag për Projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për Komunën e Podujevës;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-134 për tatimin mbi vlerën e shtuar;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit, lidhur me projektligjin nr.06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale;**
- 7. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit, lidhur me Projektligjin nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave;**
- 8. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht pa ndryshime

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-136 për ratifikimin e Marrëveshjes për Kredi, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria Ag për Projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për Komunën e Podujevës;

Kryetari: i kaloi fjalën Ministrit për prezantim dhe arsyetimin e Projektligjit.

Bedri Hamza: Theksoi se si Ministri e Financave, më 24.09.2018 kemi nënshkruar marrëveshjen e kredisë me Unicredit Bank Austria Ag në vlerë prej 5,349.000 euro për financimin e projektit të largimit të ujërave të zeza në Komunën e Podujevës.

Siç jeni të njoftuar, në vitin 2018 Qeveria e Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave e ka nënshkruar marrëveshjen e parë për bashkëpunim financiar me Qeverinë e Austrisë të përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave pasi që kjo marrëveshje e ka pasur afatin e shfrytëzimit të fondeve deri më 31.12.2016 kemi negociuar me Qeverinë e Austrisë zgjatjen e afatit edhe për dy vitet e tjera dhe kemi arritur që të negociojmë për rritjen e shumës së kredisë. Marrëveshja financiare të cilën e kemi nënshkruar ka një periudhë shtyrje prej 15 vite e gjysmë e cila përfshinë një periudhë 4 vitesh mospagimi me një normë të interesit zero si dhe reduktimin e tarifave të garancisë dhe kostove të tjera të financimit, këto tarifa në totalë arrijnë vlerën prej 1.6% që do të paguhen në baza vjetore për huazimin e këtyre mjeteve.

Për më tepër projekti në fjalë është përfshirë në kornizën afatmesme të shpenzimit 2019/20 si dhe është reflektuar edhe në tabelat e buxhetit të vitit 2019 përmes klauzolës së investimit. Bartëse e këtij projekti është Komuna e Podujevës. Hapat për arritjen e marrëveshjes financiare janë kryer në përputhshmëri me Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

Kryetari: Në fakt marrëveshja është tipike çfarë komisioni mbështet vazhdimisht dhe është marrëveshje për investimet kapitale, madje është pa interes dhe si e tillë gëzon mbështetjen time si kryetar i komisionit.

Blerim Kuçi: Kjo është hera e parë, me sa e di që kanë shkuar procedurat për kreditë të tilla dhe ne duhet të shikojmë këtë çështje të protokollit ose të njohim më mirë ose ta shkurtojmë afatet sepse po shkon gjatë. Kjo kredi është dhënë dikur në 2016 tek tash procedurat po përfundojnë. A ka mundësi ministër të qartësosh diçka ose të thjeshtosh pa e dëmtuar procesin prej momentit kur të aprovohet me kredit në Kuvend. Më intereson edhe greis periudha a është prej momentit kur është aprovuar si kredi në Kuvend apo prej cilit moment fillon kjo greis periudhë. Ju kisha lutur që protokollin i brendshëm i qeverisë me qenë disi më i thjeshtë ose të ketë njohuri më të madhe lidhur me këtë protokoll.

Bedri Hamza: Me shumë të drejtë z. Kuçi, por procedurat në Ligjin për borxhin publik janë të tilla dhe sipas raportit të Bankës Botërore është konstatuar që procedura jonë për huazime është më e komplikuar dhe është unike në botë. Është e përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligji, se marrëveshjet financiare ndërkombëtare ratifikohen me 2/3 e votave në Kuvend. Shumica e vendeve e kanë në Qeveri ose me shumicën e thjeshtë. Sa i përket thjeshtësimit të proceduarve, përveç atyre 2/3 që nuk mundemi ti ndërrojmë për shkak që është çështje e Kushtetutës dhe presim të vijë plotësim ndryshimi i ligjit për borxhin publik me qëllim që të thjeshtësohen disa procedura administrative që të jemi më efikas në kohë. Ndërsa startimi i obligimeve sigurisht fillon prej kohës së nënshkrimit të marrëveshjes e cila është nënshkruar me në këtë rast me bankën konkrete financuese edhe pret të rrjedhë edhe obligimi i kredisë.

Kryetari: Unë kam edhe një kërkesë që përveç rekomandimit për miratimin e këtij projektligji, komisioni të propozojë që i njëjti të radhitet për shqyrtim në seancën plenare të datës së nesërm.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me 8 vota Për, 1 votë Abstenim dhe asnjë votë Kundër, nxori këtë:

Rekomandimi

I rekomandohet Kuvendit të shqyrtojë dhe miratojë Projektligjin nr.06/L-136 për ratifikimin e Marrëveshjes për Kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe “Unicredit Bank Austria Ag”, për Projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për Komunën e Podujevës, në mbledhjen plenare të datës 6 dhjetor 2018, përmes shmangies nga afatet procedurale, të parapara me nenin 15, paragrafin 7 dhe nenin 56, paragrafin 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-134 për tatimin mbi vlerën e shtuar

Bedri Hamza: Në përputhje me programin e Qeverisë, kemi marrur hapa konkret për të bërë reformën fiskale të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit., që është më e madhe që ka ndodhur ndonjëherë në Kosovë. Pjesë e kësaj reforme është edhe Projektligji për TVSH.

Me hyrjen në fuqi të këtij projektligji bizneset do të kenë mundësi të paguajnë tatimin e vlerës së shtuar në brendi të vendit, një mundësi e tillë që nuk është deri më sot. Biznesi nuk do të ketë nevojë për kredi apo mënyra tjera të ndryshme të financimit për ta paguar TVSH-në me rastin e importit të mallit. Do të jetë i kursyer apo do të jetë i liruar nga të gjitha interesat e ndryshme që i kanë paguar deri sot, do të jetë i liruar nga garancionet bankare për çështjen e brendshme, do të ketë thjeshtësim të procedurave të pagesës së TVSH-së dhe shumë beneficione tjera. Çka është më e rëndësishme se kjo reformë nuk ka ndonjë procedurë administrative shtesë e cila automatikisht do të kishte kosto shtesë për bizneset.

Po ashtu përmes këtij projektligji kemi liruar nga tatimi me vlerën e shtuar lëndën e parë për subjektet prodhuese, me këtë ndihmojmë jo vetëm prodhuesit, por edhe i nxisim bizneset e vogla, të mesme për të zgjeruar prodhimin e lëndës së parë në Kosovë dhe të dekurajojmë importimin e lëndës së parë nga jashtë vendit. Dhe pasi kemi reformuar fushën e veprimtarisë të kontratat afatgjate të instalimit, dispozita ligjore është reformuar dhe këto kontrata konsiderohen si të përfunduara pa pasur nevojë të bëhet pranimiti teknik i punëve të kryera, por do të konsiderohen të përfunduara në periudhën tatimore. Shërbimet e bluarjes së grurit janë vendosur në normën e ulët, librat janë liruar në tërësi nga tatimi i vlerës së shtuar, transporti ndërkombëtar është liruar nga tatimi i vlerës së shtuar në përputhje me direktivat e BE-së shuma e kreditimit mund të kërkohet, të rimburohet është ulur nga 3.000 në 1.000 me qëllim që bizneset e vogla që janë në kreditim të mundësohet të bëhet rimburesimi dhe takim më të lehtë të ushtrimit të biznesit është një qëllim i joni për ta shtuar sa më shumë biznesin e vogël, dhe në atë të mesëm dhe sot tek zbritjet në pasuritë e paluajtshme është shkurtuar afati prej 20 viteve në 10 vite në mënyrë që të kthehet tatimi i vlerës së shtuar në afat më të shkurtë për ti mundësuar zhvillime sa më të mira biznesit.

Është rregulluar ngarkesa e kundërt e TVSH-së e cila në të kaluarën ju ka shkaktuar shumë probleme në disa sektor në biznese sidomos tek ndërtimtaria. Janë thjeshtësuar procedurat dhe deklaratimet e kontrollit të tatimit të vlerës së shtuar me qëllimin e vetëm për ti ulur shpenzimet e biznesit. Gjatë hartimit të këtij projektligji kemi marrë parasysh dokumentet relevante të Këshillit të Evropës, siç janë direktivat dhe rregulloret që e rregullojnë këtë fushë si praktika të mira evropiane dhe rajonale. Vlenë të theksohet se të gjitha institucionet për miratimin e këtij projektligji kanë qenë të përfshira gjatë hartimit të projektligjit por gjithashtu kemi biseduar dhe kemi pranuar komente edhe prej asaj forme që janë përfaqësuese të bizneseve.

Mërgim Lushtaku: Jam munduar që të shikojë projektligjin dhe me të vërtetë ministria ka bërë një punë të mirë. Megjithatë çështja e TVSH-së që është lidhur në një farë forme në kufi tash është lidhur edhe në brendi që është çështja më e madhe. Lirimi i lëndës së parë nga TVSH-ja, lirimi për librat dhe shumë pika të tjera që i përmendi ministri, janë të mirëpritura. Për mua mbetet të dyshojë apo thënë ndryshe kam një skepticizëm tek çështja e rregullimit të ngarkesës së kundërt të TVSH-së. Kisha pasur dëshirë të na ofroni analiza apo edhe një rishikim që të na bindni më shumë në këtë drejtim. Besoj që nuk është përpunuar ende në mënyrën më të duhur. Në përgjithësi unë e mbështesë si projektligj.

Kryetari: Ministër një pyetje të thjeshtë ngase na ka ardhur si kërkesë edhe nga përfaqësuesit e bizneseve dhe ka të bëjë me kthimin e Bordit të ankesave tatimore dhe doganore. A do të rregullohet me Projektligjin e ATK-së?

Bedri Hamza: Ligji për administratën tatimore dhe procedurat është në proces, është çështja e fundit për të cilën jemi duke diskutuar. Ka qenë një reformë më herët që është bërë edhe ndihmën e ekspertëve të Komisionit Evropian. Qëllimi ka qenë që kjo të kalon në kuadër të Gjykatës kompetente dhe ky është divizion i specializuar vetëm për trajtimin e lëndëve të ATK-së dhe Doganave. Mirëpo kjo nuk është implementuar ashtu siç është planifikuar dhe gjyqtarët të cilët janë punësuar aty dhe stafi profesional iu ka dhënë lëndë të natyrave të tjera dhe pastaj është bërë grumbullimi i lëndëve qysh në start dhe ata janë të mbingarkuar me punë dhe kjo realisht është duke dëmtuar biznesin.

Ne kemi bisedime të vazhdueshme me Zyrën e BE-së dhe do të vijmë në përfundim dhe nëse atje nuk funksionalizimet ne do ta kthejmë bordin dhe do të jetë pjesë e Ligjit të administratës tatimore dhe procedurat .

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se komisioni me 7 vota Për, 2 vota Abstenim dhe asnjë votë Kundër, nxori këtë:

Rekomandimi

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-134 për tatimin mbi vlerën e shtuar.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Bedri Hamza: Kur jemi te çështjet sociale, vazhdimisht jemi duke bërë thirrje që të kemi kujdes jo vetëm si ministri e financave se buxhetet tona duhet të shkojnë në përputhje me mundësitë tona për financim. Në aspektin politik e kuptoj këtë ligj, por nuk besoj që dikush nuk i do arsimtarët por duhet pasur kujdes sa kemi mundësi për ti financuar.

Për ne si Ministri e Financave situata më shqetësuese është kur skemat mbesin hapur. Ka mundësi që kosto të devijoj prej asaj fillestares në diçka që nuk mundet më as të kalkulohet. Andaj është bërë një punë e mirë në komisionin funksional gjatë amendamentimit dhe është komplet një version tjetër sa i përket aspektit financiar ku sot po e diskutojmë në raport me atë që ka qenë në lexim të parë. Kur po flasim për koston, ky ligj do të ketë shtrirje më së paku 10-15 vite.

Mirëpo pasi që është shndërruar prej një skeme të hapur që e ka pasur komplet një vlerë tjetër në një diçka që është e matshme ne për vitin e ardhshëm dhe vitet vijuese e kemi bërë pjesë tabelave të buxhetit dhe vlerësimet për dy vitet në vazhdim edhe koston për financimin e këtij ligji. E kam thënë edhe në Kuvend që është precedent dhe do të përdoret si precedent edhe për kategoritë tjera.

Kryetari: Keni plotësisht të drejtë zoti ministër, në fakt këto janë edhe kritikant kryesore që do të bëjmë buxhetit të këtij viti që po shndërrohet në buxhet social gradualisht dhe për më tepër nuk tarrgëton kategoritë e varfra. Po të ishte social dhe po ti tarrgëtonte shoqëritë e varfra do të kishte kuptim. Unë edhe pse jam nga një familje që kanë qenë punëtorë të arsimit, përkundër kësaj nuk mundem të mbështes një iniciativë të tillë dhe do të abstenojë, dhe atë për çështjet parimore që kam. Ju lutem që këtë çështje ta ngrisim edhe në një nivel më të madh sepse nuk kemi për të pasur gjasë pas disa viteve me këtë trend ti përballojmë si shtet këto lloje shpenzime. Ky është vetëm fillimi, kanë për të ardhur policët, mjekët, gjykatësit, shtesat e fëmijëve, lehonisë, dhe nuk e di ku do ti marrim paratë dhe nuk e di si po krijojmë vende të punës më pas, si po zhvillojmë këtë vend me çfarë arsimit me çfarë shëndetësie po e lëmë këtë vend.

Naser Osmani: Pyeti a janë këto para vetëm pension kontributdhënës apo është një shtesë jashtë rrogës që ai e merr këtë vlerë dhe e harxhon sot për atë që ka punuar dikur, vetëm këtë dua të ma sqaroj ministri?

Bedri Hamza: Ky është një version që është ndryshe dhe ka ardhur si rezultat i amendamenteve dhe punës së komisionit funksional. Të gjithë këta do ta marrin këtë shtesë mbi pensionin nën supozimin që kanë punuar edhe një vit në sektorin e arsimit. Pra pensionet do të mirren në moment të pensionimit Besoj që Kosovës i duhet një diskutim më i gjatë në skemat sociale edhe një riorganizim i gjithë skemës sociale dhe kategorive, të gjitha nivelet.

Naser Osmani: Punëtorë e arsimit janë paguar për punën që kanë marrë dhe unë mendojë që janë mbi 180 milion në pagat që vetëm ata kanë marrë, që ka qenë një pagë e dinjitetshme për në atë kohë. Edhe shumë punëtorë serbë të arsimit janë shkëputur nga sistemi i Serbisë dhe janë kyçur në sistemin tonë, kjo është për shkak të pagës së mirë. Këtu kam një situatë që unë kam problem me vetveten, për krejt i kam ato shënime, janë shënime të sakta komunë për komunë sa para kanë marrë arsimit e të gjitha. Unë po tregojë që aspak nuk i përkrahu, sepse ka të bëjë me atë që ketë vend e kemi shndërruar si një pus dhe vetëm marrim ujë nga aty sa të mundemi. Unë kam punuar dy vite por pa rrogë dhe vullnetarisht kam hequr dorë nga rroga. Me të vërtetë unë nuk e di, nuk e kamë atë guxim as të dalë nesër në foltore dhe skam guxim as të vërtetoj këtu nuk kam fuqi.

Arbërie Nagavci: Duke qenë anëtare e Komisionit për Arsim e përmendi edhe ministri se ky projektligj dallon shumë prej draftit që është aprovuar në Qeveri dhe përkundër presionit shumë të madh që kemi pasur nga sindikatat sepse e kanë atë punë dhe aq më tepër kur ky ka qenë premtim elektoral i Kryeministrit që më pas është aprovuar në Qeveri. Sido që të jetë pak e përmendi edhe ministri që kemi bërë disa ndryshime, ku ndryshe prej fillimit ishte propozuar që të kemi vetëm dy ndarje, kemi shkuar nga 1-9 vite. Pra nëse një punëtor ka punuar një vit e merr një vlerë deri në 14 euro që është minimumi dhe maksimumi shkon deri në 70 euro. Sa i përket trashëgimisë së pensionit, kemi bërë ndryshime dhe si rezultat ka mbetur që të trashëgojë pensionin vetëm bashkëshorti/ja. Po ashtu në draftin e parë, përfitues kanë qenë edhe personat e gjitha institucionet tjera që kanë lidhje me arsimin edhe në institute akademike tjera dhe me amendamentet janë hequr këto kategori. Unë mendoj që është një draft shumë më i mirë se sa ai që ka ardhur. Gjatë tërë kohës kemi qenë në diskutim me të gjithë zyrtarët e financave që na kanë ndihmuar shumë në aspektin e kostot buxhetore.

Blerim Kuçi: Më vjen mirë sepse ministri tha që është krijuar një sistem i mbyllur. Po të kishte mbetur i hapur me të vërtetë do të kishim pasur probleme sepse ka të bëjë jo vetëm me arsimtarët por edhe me kategoritë e tjera të cilat janë lidhur. Ka diçka të mirë sepse edhe skemat pensionale të kontributdhënësve janë në amortizim. Duhet të bëjmë një analizë më të thellë dhe duhet të jemi më të kujdesshëm, ky ka kaluar në lexim të parë duhet edhe të kalojë në këtë formë të amendamentuar dhe nuk shohim ndonjë rrezik, por disi duhet ti ndalim sepse ky është një lloj vargu edhe për kategoritë tjera.

Bedri Hamza: E tha kryetari me shumë të drejtë, unë mendoj që skemat sociale, pensionale në Kosovë duhet të kenë një trajtim, mirëpo edhe kur jemi te pensionet kontributdhënëse prapë jemi të padrejtë. Ata paguhen nga taksat dhe tatimet siç paguhen këta pensionistët e pleqërisë.

Kur kam propozuar në buxhet të vitit të ardhshëm rritjen e pensioneve të pleqërisë për 20% dhe këta janë targeti sepse ky me 90 euro nuk mundet të jetoj ndaj kemi krijuar pabarazi, prandaj dua të besoj që në një moment në një të ardhme të përshtatshme çështja e pensioneve, transfereve sociale do të adresohet.

Ali Lajçi: Pavarësisht sistemeve tjera, kudo në histori arsimit ka qenë progresiv edhe kohën e viteve 41, 42, 44, 45 e tjera, kur ky arsim ka qenë më i veçantë në kuptim të një rezistence edhe politike. Po shifet se me ndryshimet që ka bërë komisioni funksional, projektligji është ndryshon nga drafti fillestar, por është një shpjegim i mirë me fuqinë buxhetore dhe rritjen ekonomike rriten mundësitë e përballimit dhe shtrirjes së financimit.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se komisioni me 4 vota Për, 3 vota Abstenim dhe asnjë votë Kundër, nxori këtë:

Rekomandimi

Projektligji nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projekt ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari: Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Por me qëllim të harmonizimit të Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe me amendamentin 21 të komisionit funksional për këtë projektligj, propozojë ta bëjmë një amendament me tekstin si në vijim: “Neni 11, paragrafi 2, në fillim të nën paragrafit 2.5, teksti “I propozon Kuvendit buxhetin e hartuar nga Këshilli”, ndryshohet me tekstin “procedon buxhetin e hartuar nga Këshilli”

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se komisioni me 8 vota Për, 1 votë Abstenim dhe asnjë votë Kundër, nxori këtë:

Rekomandimi

1. Projektligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nga Grupi Parlamentar Lista Serbe, nga deputetja Albulena Haxhiu, deputeti Hajdar Beqa dhe deputetja Fitore Pacolli, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendament në Projektligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, si vijon:

Amendamenti 1

Neni 11, paragrafi 2, në fillim të nën paragrafit 2.5, teksti “I propozon Kuvendit buxhetin e hartuar nga Këshilli”, ndryshohet me tekstin “procedon buxhetin e hartuar nga Këshilli”

6. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit, lidhur me Projektligjin nr. 06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale

Naser Osmani: Raportoi se grupi punues ka shqyrtuar projektligjin dhe se amendamentet e propozuara, janë bërë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme të dispozitave të projektligjit, të natyrës së rregullimit formalo-juridik dhe rregullimeve gjuhësore. Ndryshimi më i rëndësishëm ka të bëjë me çështjen e rritjes së përqindjes së zbritjeve nga tatimi nga 10% në 20% nëse parashihet me ligjet të veçanta për ata që sponsorizojnë në sport, kulturë dhe të fusha të ngjashme. Kjo ka të bëjë me zbritjet e lejuara tatimore për sponsorizimet në sport, kulturë e fusha të ngjashme. Në Projektligj ka qenë e lejuar zbritje për qëllime të tilla në 10% dhe plus 10% përqind nëse parashihet me ligje të veçanta. Ne kemi propozuar që përqindja 10 të bëhet 20 përqind nëse parashihet me ligje të veçanta. Pra gjitha ata që kontribuojnë apo sponsorizojnë në sport dhe fusha tjera të përmendura në ligj, do të përfitojnë edhe 10% më tepër, pra në total 30%.

Përveç amendamenteve të prezantuara në raportin e grupit punues, propozojë edhe një amendament me radhë, si në vijim: “që në nenin 3, në përkufizimin “1.18. Rezident”, në nën paragrafin 1.18.2., të hiqet teksti si vijon: “ose ka vendin e menaxhimit të tij efektiv në Kosovë”. Kjo është një kërkesë e ATK-së, me qëllim të qartësimit të definicionit “rezident” dhe harmonizimit me Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Blerim Kuçi: Theksoi se kur kemi biseduar në grup punues lidhur me çështjen e lirimeve tatimor si rezultat sponsorizimeve, kanë qenë dy dilema: lirimi nga në tatimin në fitim apo në procedura rregullat siç parashihet me ligjet tatimore? Si grup punues, kemi vlerësuar se me këtë ligj që është bazik për tatime duhet të rregullohet kjo çështje, pasi që duhet pasur kritere dhe evidenca të sakta për çështjen e kontributeve dhe sponsorizimeve në të gjitha fushat që të mund të aplikohen pastaj zbritjet nga pagesa e tatimeve.

Mërgim Lushtaku: Unë dëshiroj të di se si është e rregulluar kjo çështje me ligjin mbi sponsorizimin e sportit, a është i njëjtë a ka ndryshime me këtë ligj?

Naser Osmani: Ligji për sponsorizimet faktikisht është ligj të cilin ministria duhet të tërheq, sepse ky është tash ligji bazik për çështje të tatimeve. Më pas z. Osmani e shpjegoi përmes kalkulimeve monetare se si do të duket pagesa e tatimit si rezultat i zbritjeve prej 30% për ato subjekte që sponsorizojnë në sport dhe në fusha ngjashme.

Kryetari: Propozojë miratimin e amendamenteve të propozuara nga grupi punues, me tre amendamente shtesë sipas tekstit të propozuara nga z. Osmani.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se komisioni me 7 vota Për, 2 vota Abstenim dhe asnjë votë Kundër, nxori këtë:

Rekomandimi

1. Miratohet Propozim-amendamentet e Grupit Punues të Komisionit, lidhur me Projektligjin nr. 06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale, me tre amendamentet shtesë, sipas propozimeve të

deputetit Naser Osmani. Ndërsa, Komisionit nuk përkrahur amendamentin e propozuara nga deputeti Bekim Haxhiu dhe amendamentin e propozuara nga deputetja Shqipe Pantina.

2. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përhershëm të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Grupit Punues të Komisionit, lidhur me Projektligjin nr. 06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave

Naser Osmani: Theksoi se si grup punues kemi shqyrtuar projektligjin, kemi bërë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në aspektin e rregullativës juridike të zbatimit të ligjit. Ndër ndryshimet kryesore kanë të bëjnë me çështjen e rritjes së përqindjes së zbritjeve nga tatimi nga 10% në 20%, nëse parashihet me ligjet të veçanta për ata që sponsorizojnë në sport, kulturë dhe të fusha të ngjashme. Kjo ka të bëjë me zbritjet e lejuara tatimore për sponsorizimet në sport, kulturë e fusha të ngjashme. Në Projektligj ka qenë e lejuar zbritje për qëllime të tilla në 10% dhe plus 10% përqind nëse parashihet me ligje të veçanta. Ne kemi propozuar që përqindja 10 të bëhet 20 përqind nëse parashihet me ligje të veçanta. Pra gjitha ata që kontribuojnë apo sponsorizojnë në sport dhe fusha tjera të përmendura në ligj, do të përfitojnë edhe 10% më tepër, pra në total 30%.

Janë dy momente me të cilat jemi ballafaquar asi grup punues dhe janë ato të cilat duhet të merremi si komision. I pari ka të bëjë me kërkesën e institucioneve bankare dhe institucioneve të sigurimeve që na kanë kërkuar të bëjmë një formulim të asaj që ka qenë që ministri të nxjerrë aktin nënligjor sa i përket këtyre shpenzimeve apo humbjeve që ka kohë që po konsiderohen si humbje nga kreditë, përkatësisht rezervat teknike dhe matematike.

Për shkak të propozimeve të ndryshme, nga njëra anë që të mbetet si në projektligj, që këto njohje të rregullohen me akt nënligjor të nxjerr nga ministri i Financave, dhe në anën tjetër kemi pranuar propozime që këto njohje ti lihen të vendos BQK-ja, propozimi im është që kjo çështje të rregullohet me ligj, dhe të shtojmë dy amendamente, me tekstin si në vijim:

Amendamenti i parë, të riformulohet paragrafi 2 i nenit 14, me tekstin si në vijim: “Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, të licencuara nga BQK-ja, për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, kanë të drejtë që të njohin shpenzime të zbritshme provizionet për humbjet e pritura nga kreditë deri në 80% (tetëdhjetë) për qind, të shumës së përcaktuar me akt nënligjor, të nxjerr nga BQK-ja”.

Amendamenti i dytë, të riformulohet paragrafi 3 i nenit 14, me tekstin si në vijim: “Institucionet financiare të sigurimeve dhe risigurimeve, të licencuara nga BQK-ja, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, kanë të drejtë që t’iu njihen shpenzimet e zbritshme, provizionet për rezervat teknike dhe matematike, deri në 80% (tetëdhjetë) për qind, të shumës së përcaktuar me Ligjin për Sigurimet dhe aktet nënligjore të nxjerrë nga BQK-ja.” Faktikisht ky është një kompromis mes kërkesave të ministrisë dhe kërkesave të shoqatës së sigurimeve dhe të shoqatës së bankave.

Përveç këtyre dy amendamenteve, propozojë ta bëjmë edhe një amendament në përkufizime, me tekstin si në vijim: “Neni 3, në përkufizimin “1.18. Rezident”, në nën paragrafin 1.18.2., të hiqet teksti si në vijim: “ose ka vendin e menaxhimit të tij efektiv në Kosovë”. Kjo është një kërkesës e ATK-së, me qëllim të qartësisht të definicionit “rezident” dhe harmonizimit me Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Blerim Kuçi: Z. Naseri e tha dilemën e tij për aktet nënligjore dhe me të vërtet është pak problem duhet t’ia lëmë BQK-së apo Ministrisë së Financave. Ministria e Financave ka të bëjë me taksat dhe tatimet që është lidhur me shtetin. Atë ditë kemi pasur dilema dhe është pak vështirë të përcaktohem, po unë do ta kisha lënë tek Ministria e Financave sepse ajo është kompetente mbledhjen e këtyre të hyrave. Me lënë tek BQK-së, ky koordinimi i BQK-së me këto bankat nganjëherë është mjaft i ndërlikuar duhet ta lëmë jashtë dhe mirë që është jashtë.

Kryetari: Propozojë miratimin e amendamenteve të propozuara nga grupi punues, me një amendament shtesë sipas tekstit të propozuara nga z. Osmani.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se komisioni me 6 vota Për, 2 vota Abstenim dhe asnjë votë Kundër, nxori këtë:

Rekomandimi

1. Miratohet Propozim-amendamentet e Grupit Punues të Komisionit, lidhur me Projektligjin nr. 06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, me tre amendamentet shtesë, sipas propozimeve të deputetit Naser Osmani. Ndërsa, Komisionit nuk përkrahur amendamentin e propozuara nga deputeti Bekim Haxhiu.
2. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përhershëm të Kuvendit.

8. Të ndryshme.

8.1. Kryetari: Theksojë se ju kujtohet rasti i kërkesës së Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, z. Arsim Rashiti, ne kemi kërkuar nga Zyra Ligjore e Kuvendit një këshillë ligjore dhe ajo është dërguar. Sipas këshillës ligjore, Drejtori i ARRU-së, ka nxjerrur vendim sipas të cilit, Kryesuesi do të paguhet në formën e mëditjeve, në shumë prej 65.00 euro për takimet e mbajtura për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve rregullatore.”. Prandaj, unë propozojë që ti kthejmë përgjigjen z. Rashiti, këtë përgjigje dhe shpresojë që çështja e kompensimit të kryesuesit do të rregullohet me ligjin për pagat.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht vendosi që ti kthejë përgjigje z. Arsim Rashiti, Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, me tekstin si vijon:

“Bazuar në Ligjin nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, si dhe Vendimin e Drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, datë 2 korrik 2018, Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, kompensohet në formën e mëditjeve në shumën 65.00 euro për çdo takim të mbajtur për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve rregullatore.”

8.2. Kryetari: Propozojë që të caktohen dy grupet punues për shqyrtimin e Projektbuxhetit 2019 dhe kërkesave buxhetore, të cilët do të mbajnë takimet pas miratimit në lexim të parë të Projektbuxhetit 2019.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, vendosi që të caktohen dy Grupet Punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, si në vijim:

Grupi i parë punues për shqyrtimin e Projektbuxhetit të institucioneve qendrore, përfshirë institucionet/agjencitë e pavarura për vitin 2019, me këtë përbërje: Lumir Abdixhiku, kryesues, Mërgim Lushtaku, anëtar, Dardan Molliqaj, anëtar, Arbërie Nagavci, anëtare, Enver Hoti – anëtar, dhe Fikrim Damka – anëtar dhe Grupi i dytë punues për shqyrtimin e Projektbuxhetit të institucioneve lokale, me këtë përbërje: Safete Hadergjonaj, kryesuese, Jelena Bontic, anëtare, Naser Osmani, anëtar, Ali Lajçi , anëtar, dhe Blerim Kuçi, anëtar,

8.3. Kryetari: Njoftoi anëtarët e Komisionit se GIZ ka angazhuar një eksperte të jashtme, znj. Artane Rizvanolli, për të analizuar Projektbuxhetin e vitit 2019, që ka përgatitur një analizës e cila iu është

shpërndarë të gjithëve dhe sot është ftuar që të njëjtën ta paraqes në komision. Ne kemi diskutuar edhe më herët, edhe me GIZ, që presim të na ndihmojnë në krijimin e zyrës buxhetore brenda parlamentit që do të bëni analiza buxhetore për nevoja të komisionit.

Mërgim Lushtaku: Ne kur kemi qenë në një vizitë në Vjenë, kemi parë përvojat e Austrisë në ofrimin e ekspertizës për komisionin e buxhetit dhe deputetët përmes angazhimit të ekspertëve dhe atyre nga bota akademike. Unë mendoj se edhe ne si komision do të ishte mirë të organizonin një dëgjim publik për Projektbuxhetin dhe të ftonin profesor dhe njerëz nga universitetet dhe institutet akademike që do të na ndihmonin me idetë dhe propozimet e tyre.

Më pas Artane Rizvanolli eksperte e jashtme e angazhuar nga GIZ, prezantoi para anëtarëve të komisionit analizën lidhur me Projektligjin nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:40.
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku